

URDHËR
Nr. 630, datë 6.11.2023

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR, GJIMNAZI “NILS BOR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe urdhrin nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor”, të subjektit juridik “Nils Bor” sh.p.k, i licencuar me urdhrin nr. 506, datë 3.12.2008, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor””, me kërkesën e tij nr. 221 prot., datë 4.9.2023.

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor”, ka për detyrë:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

b) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar, Gjimnazi “Nils Bor”.

b) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

c) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor”, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 506, datë 3.12.2008, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, Gjimnazi “Nils Bor””, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “Nils Bor”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Nina Guga

